

Lentet fakike (ICL/IPCL) ne korrighimin e difekteve te ndryshme te refraksionit

(Eksperienca 10 vjecare ne Kliniken Gjermane te Syrit ne Tirane)

Stela Ceca, MD, Minir Asani , MD

Qellimi : Te valutohen rezultatet dhe komplikacionet e mundeshme te implantimit te lenteve ICL/IPCL ne pacient me difekte te ndryshme te refraksionit ne nje follow-up minimumi 5 vjet.

Metoda: Ne 10 vite jane implantuar 61 lente ICL/ IPCL ne kliniken Gjermane te Syrit ne Tirane nga te cilat 10 ne pacient me keratokonus te stabilizuar, 5 sy post keratoplastike, 6 sy me hyperopi dhe astigmatizem dhe 30 sy me miopi te larte. Para se ti nenshtroheshin nderhyrjes kirurgjikale pacientet kane kryer ekzaminim te detajuar oftalmologjik: vizusi pa korrighim dhe me korrighim (BCVA) ne mioze dhe cikloplegji, Autorefraktometri/Keratometri (Huvitz HRK-9000°), Topografia Korneale dhe matja e Vault me Scheimpflug (Allegro Oculyzer WaveLight), Biometria, (Allegro Biograph), Pupilometria, Microscopia Speculare (Tomey EM-3000), Fundoskopi dhe OCT e NO dhe e makules (OCT Optovue/Angiovue). Pacientet qe permbushnin te gjitha kriteret i jane nenshtuar nderhyrjes per implantimin e lenteve fakike. Ne pacientet me astigmatizem te larte jane implantuar IPCL V2.0 TORIC (Care Group) ndersa ne pacientet me miopi te larte jane implantuar ICL (Staar Surgical). Pacientet u kontrolluan me SL, Goldman tonometri dhe matja e ICL Vault me Scheimpflug Tomography ne ditet 1, 3 dhe pas 1, 3 e 12 muajsh.

Rezultatet: Vizusi rezultoi te pakten 2 rreshta me shume nga BCVA para kirurgjise ne te gjitha pacientet dhe mbeti e pandryshuar gjate gjithe follow-up. Ne 10 sy TIO > 20 mmHg ne javen e pare te operacioni u menaxhua me hipotonizant lokal per maksimumi 2 jave. Ne 2 sy u be nderrimi i lenteve per shkak te Vaultit < 300 micron. Asnje pacient nuk pati komplikacione retinale. Nje pacient pati dislokacion te ICL 3 muaj pas nderhyrjes si pasose e nje goditje ne sy dhe lentja u ripozicionua pa asnje komplikim pas 2 ditesh. Shkelqimi i dritave u ankua vetem ne periudhen e pare post-operatore.

Konkluzion: Lentet fakike ICL ose IPCL jane shume efikase ne trajtimin e difekteve te larta te refraksionit ose ne rastet kur trajtimi ne lazer ne korne eshte i kunderidikuar. Ato kane nje siguri dhe stabilitet aftagjate, komplikime te menaxhueshme dhe kthyeshmeri.